

KONTRATE

PER THEMELIMIN E SHOQERISE ANONIME "RRUGA URA ASFALTIM ELBASAN Nr. 2" SH.A



Me vendimin e esamblese se jashtezakoshme daten 19.3.1996 eshte vendosur ndarja pa likujdim e shoqerise anonime "RRUGA URA ASFALTIM ELBASAN". Me kontraten e ndarjes date 2.6.1996 me numur repertori 5505 dhe numur koleksioni 2645 eshte krijuar shoqeria anonime RRUGA URA ASFALTIM ELBASAN NR.2 me pjesemarrjen e 48 aksioniereve sipas listes bashkeliidhur kesaj kontrate. me kontraten e pjestimit eshte pjestuar kapitali i shoqerise. Keto dokumenta jane depozituar ne zyren e regjistrat tregtar te gjykates Tiranë me vendimin e gjyqtarit te vete nr.11757/2 date 12.6.1996.

TE GJITHE AKSIONERET RANE DAKORT SI ME POSHTE:

Neni 1

Te krijojne shoqerine anonime qe me poshte do te quhet shoqeria me emertimin "RRUGA URA ASFALTIM ELBASAN Nr.2" SH. A. Shoqeria do te ketë seline ne Republikën e Shqiperise, ne qytetin e Elbasanit. Ilegjia Beqir Dardha.
Kohezgjatja e veprimitarise se shoqerise eshte pa afat.


Neni 2

Ne baze te legjisacionit shqipetar shoqeria eshte person juridik dhe veprimitaria e saj nregullohet sipas ligjit per shoqerite anonime. Legjisacionit shqiptar qe nregullon kete veprimitari, statutit te shoqerise dhe kesaj kontrate qe eshte pjesa e pandashme e tij.

O B J E K T I

Neni 3

Objekti i veprimitarise se shoqerise eshte:
Ndertimi i veprave publike ne lindje me sektorin e ndertimit dhe asfaltimit te rrugeve. Ndertimit te urave, porte e aeroporte, linjeve hekurudhere dhe veprave ndertuese te tjera. Supervizion per te gjitha llojet e ndertimit qe ka per objekt projektimin e rrugeve dhe veprat te tjera qe te ndertohen ne rruge, pa urat e medha. Ndertimi



i veprave ujntese, kanalizimeve, ujeçjellessa. Kultivimi i
barierave per inert, prodhim i betoneve, i asfaltobetoneve, i
elementeve te para perqatitur e paratensionuar, ndertime metalike
ose mikse, mirembajtje e rikonstruksione ohe tregtimi i ketyre
produkteve, eksport-import. Per arritjen e ketyre qellimeve
shoqeria mund te zhvilloje cfareddoltoje veprimtarie industriale,
tregtar, ekonomiko-financiare, qe do te gjykoher te nevojshme e
te dobishme per realizimin e objekteve te shoquerise si die cdo
operacion finanziar, tregtar, industriale qe lidhen
drejtoperdorejte ose terthorszi me objektin e veprimtarise se saj
ose qe jane te lidhura me te gjithe pasurine e shoquerise. Te
kryeje cdo bisnes te pershtatshem per arritjen e qelliimit te saj.
Te kryeje veprimtarit te perbashketa me shoqeri te tjera.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Neni 4

Kapitali themeltar i shoquerise eshte 32.356.506 leke i
perbere nga kontributi i 48 aksionereve.
Kapitali eshte i ndare midis aksionereve sipas perqindjes ne
listen bashkelidhur.

Ne librin e llogarise te shoquerise krijohet fondi themeltar
i aksionereve ku shienohen kapitalet e vane nga secili aksioner.

Neni 5


Shoqeria e fillon veprimtarine e saj pas regjistrimit ne
regjistrin tregtar te gjykates Tirane dhe per veprimtarite per te
cilat legjislatoni kerkon teje te vecants pas nxjerrjes se tyre.
Moas regjistrimit person juridik shoqeria regjistrohet ne zyren
tatimore ku pajiset me certifikate regjistrimi.
Fitimi i shoquerise pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe
zbritjes se fondeve te detyruara do te ndahet ndermjet
aksionereve perpjestimisht me kontributet e tyre ne kapitalin
themeltar.

Neni 6

Organet drejtuese te shoquerice janet:
Asambleja e aksioniereve.
Keshilli mbikqvres
Drejtori.

Neni 7

Keshilli i pare mbikqvres i shoquerise perbehet nga tre antar
dhe nge radhet e tij u zgjidhe kryetari. Antaret e pare te



keshillit mbikqyres dhe eksperiti kontabel i autorizuar caktohen per nje afat orej tre vjetesh.
Mbas perfundimit te afatit te antareve te pare te keshillit mbikqyres dhe ekspertit kontabel te autorizuar emerimi dhe zgjedhja e tyre behet ne perputhje me kerkesat e ligjit per shoqerite tregtare.

Neni 8

Keshilli i pare mbikqyres do te perbehet si ne poshtë:
1. Zyber Hasa kryetar
2. Kati Kocaj antar
3. Ramadan Bandholi antar

Neni 9

Keshilli mbikqyres vendosi drejtor te shoqerise zotin Petrit Xhunga Lindur e banues ne Elbasan. Ai emerohet per nje periudhe 1 vjecare dhe mbas ketij afati mund te riemerohet. Aktin e emerimit te tij e nenshkroi kryetari i keshillit mbikqyres.
Eksperi i pare kontabel u caktua Besa Bashllari.

Neni 10


Aksioneret e shoqerise detyrohen te rusejne karakterin e fshehte te dokumentacionit, te informatave, te njoftimeve dhe te pervojes se shkembyer ose te realizuar ne kuadrin e shoqerise dhe te marrin te gjitha masat e nevojshme per te shmangur perhapjen e tyre qofte edhe pjesërisht.
Ortaket pergjigjen per pasojat e demshme qe rrjedhin nga shkelja e mirdeshme e detyrimeve te mesiperme ne qofte se shkelja ka ndodhur nga nje veprim i qellimshem ose nga pakujdesia.

Neni 11

Kjo kontrate eshte e vleshi nga dita e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar te gjykates Tiranë. Prishja dhe llikujdimi i shoqerise behet ne perputhje me statutin e shoqerise qe eshte pjesa perbereze e kësaj kontrate duke zbatuar rigorozisht rrregullat e percaktuara ne ligjin per shoqeride tregtare.

Neni 12


Cdo mosmarrëveshje midis paletave kontraktuese do te zgjidhet ne rrugen e mirekuptimit ne rast te kundert palet do ti drejtohen gjykates kopetente.



Nen i...13

Per pasqyrimin e vepriinterise se saj shoqeria do te pajisjet
me gjithe librat dhe dokumentacionin qe kerkon ligji per
shoqerite anonime.
Kjo kontrate u perfilua ne kalem kopje me fuqi te barebarta.

KRYETARI I KESHILLIT MBIKOQYRES




REPUBLICA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE

Nr. 3804 rep
Nr. 514 kol

V E R T E F I M

Sot me daten 11.02.1996 para meje noteres u paraqite Zyber Hasa per identitetin e te cilit u sigurova me leter njofftim. Ai eshte madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar i cili deklroi se kontrata e mesiperme eshte shkruar sipas vullnetit te plete e te lire te aksionereve e nenshkrueve para meje noteres dhe une e vertetoj sipas ligjit.

MOTEP
MINISTERIA
TIRANE, ALBANIA




[Signature]

S T A T U T I

I SHOQERISE ANOMINE "RRUGA URA ASFALTIM ELBASAN NR. 2"

Themeluesit, 48 aksioneret sipas listes bashkeliidhur deklarojne se krijuan shoqerinie anonime "EMERTEKONTIMIN "RRUGA URA ASFALTIM ELBASAN Nr.2"



DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Shoqeria eshte krijuar si person juridik dhe fiton te drejten e personit juridik qe nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregtar te gjykates Tirane. Shoqeria do te jetet anonyme pa oferte publike persa koha qe asambleja e aksionereve anonime me oferte publike osa ne nje forme tjeter te shoqerive tregtare te parashikuara ne ligjin 7636 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

Neni 2

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar per shoqerite tregtare dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijuimit te saj statutin dhe kontraten.

Neni 3

Emertimi i shoqerise do te jetet "RRUGA URA ASFALTIM ELBASAN Nr.2"

Neni 4

Selia e shoqerise do te jetet ne qytetin e Elbasanit tagjia Beqir Dardha.

Selia e shoqerise mund te transferohet me vendim te keshillit mbikyres me kusht qe ky vendim te miratohet ne mbledhja me e afert e asamblese se pengjitheshme. Shoqeria mund te krijoje dege e perfaqesi sipas nevojave te saj.



Neni 5

Kona e veprimtarise se shoqerise eshte pa saj. Kohezgjatja e saj mund te naryshoje me vendim te mbledhjes se jashtezakonshme te aksionereve.

Neni 6

Shoqeria do te kete vulen e saj me permbajtje "RRUGA URA ASFALTIM ELBASAN Nr.2" SH.A ALBANIA.

Te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxirren nga shoqeria do te tregojne lexueshem emrin e saj.

O.B.J.E.K.T.I


Neni 7

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:
Ndertimi i veprave publike ne lidhje me sektorin e ndertimit dhe asfaltimit te rrugeve, ndertimit te urave, porte e seroporte, linjave hekurudhere dhe veprave ndertuese te tjera. Supervizion per te gjitha llojet e ndertimit qe ka per objekt projektimin e rrugeve dhe veprave te artit ne rruge, pa urat e medha. Ndertimi i veprave ujitese, kanalizimeve, ujesjellesa. Kultivimi i barierave per inerte, prodhim i betoneve, i asfaltobetoneve, i elementeve te para pergetitur e paraterisionuar, ndertime metalike ose mikse, mirembajtje e rikonstrukione dhe tregtimi i ketyre produkteve, eksport-import. Per arritjen e ketyre qelliimeve shoqeria mund te zhvilloje cfaredolloje veprimtarie industriale, tregtare, ekonomiko-financiare, qe do te gjykojen te nevojshme e te dobishme per realizimin e objekteve te shoqerise si dhe cdo operacion financiar, tregtar, industriale qe lidhen drejteperdrejte osa te terthorazi me objektin e veprimtarise se saj ose qe jene te lidhura me te gjithe pasurine e shoqerise. Te kryeje cdo bisnes te pershtatshem per arritjen e qellimit te saj. Te kryeje veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 32.356.506 leke i perbere nga kontributi i 46 aksionereve.





Kapitali eshte i ndare midis aksionereve sipas perqindjes ne
listen bashkëlidhur.

Ne librin e llogarise te shoqerise krijuhet fondi themeltar
i aksionereve ku shenohen kapitalet e vone nga secili aksioner.

Vlera nominale e aksionit eshte 1000 leke e barabarte me nje
vote.

Neni 9

Ndryshimi i kapitalit behet me vendim te asamblese se
Jashtezakonshme. Keto veprime behen ne baze te nenit 152 te
ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare". Ne baze te
ligjit aksioneret kane perpjestimisht me shumen e aksioneve te
tyre nje te drejte paresore ne nenshkrimin e aksioneve te para te
emertuara per te kryer nje zmadhim te kapitalit. Ata mund te
heqin dore nga kjo e drejte vetem individualisht. Asambleja e
jashtezakonshme mund te autorizoje ose te vendose zgjedhjen e
kapitalit per sresye te veprimtarise ose ligjore, por ne asnjë
rast zgjedhja i kapitalit nuk mund te cenoje aksioneret.

Zgjedhja i kapitalit per cdo shkak ne nje shume me te vogel
se minimumi ligjor mund te vendoset vetem me kushtin pezullues te
nje zmadhimi te kapitalit i destinuar te coje kete te fundit te
paktën ne minimumin ligjor, pervec rastit kur shoqeria
trasferohet ne nje forme tjeter ligjore qe nuk kerkon nje kapital
me te larte se ai i zgjeluari. Ne rastin e moszabetimit te keqaj
dispozite cdo i interesuar mund te kerkoste nga gjykata
kompetente prishjen e shoqerise. Prishja e shoqerise nuk mund te
shpallet nese ne dten e gjykimit te ceshtjes gjendja eshte
nregulluar.

AKSIONISTET DHE AKSIONER


Neni 10

Pronesia mbi aksionet permban aderimin me te drejta te plota
ne statutin e shoqerise nepermjet perfaqesimit ne asamblene e
pergjitheshme te aksionereve.

Aksioneret kane te drejte te marrin pjesen e fitimit vjetor
te destinuar nga asambleja e aksinereve per ndarje. Ky fitim
ndahet ne perputhje me kontributin ne kapitalin themeltar.
Cdo aksionist ka te drejte te marrje kur eshte rasti nje pjeze nga
teprica e likuidimit te shoqerise ne te njejtin perpjestim me
kontributin ne kapitalin themeltar.

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne
asamblene e pergjitheshme sipas ligjeve ne fuqi dhe normave te
perakteuara ne statut.

Aksioneret janë pengjegjës per detyrimet dhe humbjet e
shoqerise deri ne kufirin e vleres nominale te aksionit qe
zoteron. Kerkimi i fondeve tej kesaj mase eshte i ndaluar.



Te drejtat dhe detyrimet e permendura ne kete nene ndjekin aksionin ne cfaredo forme qe si tjetersohet tek te tretet.

Neni_11

Aksionet jane te formes emerore. Pronesia e tyre eshte e regjistruar ne librin e aksionereve te shoqerise. Libri i aksionereve permban identitetin e aksionistik, adresen, numrin dhe kategorine e aksioneve, totalin, vleren nominale te aksionit, numrin e aksioneve, perqindjen ne kapitalin e shoqerise.

Secili aksionere ka te drejte ti mbaje ne nje ekstrate keto te dhene te nxjerra nga libri te vertetuara me vulen e shoqerise. Secili aksionere ka te drejte te verifikoje te dhenat e tij ne librin e aksionereve.

Neni_12

Aksionet Jane te trasferueshme.
Trasferimi i pronesise se aksioneve nominative kerkon tejen me shkrim te keshillit mbikyres.

Pronesia ne trasferimin e aksioneve nominative ju takon aksioniereve te tjere te shoqerise sipas radhes se paraqitjes se ofertes dhe ne rast te paraqitjes se njehershme te ofertes i takon keshillit mbikyres te vendos per caktimin e radhes.

Keshilli mbikyres cakton bleresin gjate tre muajve llogaritur nga data e paraqitjes se ofertes te trasferimit te aksioneve. Ne rast se keshilli mbikyres nuk cakton gjate besaj periudhe bleresin, pronari i aksionit mund t'ia shesi ate nje personi te cfaredoshem fizik ose juridik me cmim te lire por jo me te ulat nga ai i afroar aksionereve te tjere.


Ne rast se bleresin e cakton keshilli mbikyres cmimi i shitjes se aksioneve nominative do te caktohet sipas vleres aktuale te bilancit te shoqerise.

Ndryshimi i pronesise se aksioneve si rrnjedhoje e nje shitje ose trasferimi kryhet nepermjet kalimit nga llogaria e dhenesit tek llogaria e marresit. Shoqeria eshte e detyruar te kryeje regjistrimin dhe xhirimin brenda gjashte diteve nga marrja e urdher xhirimit.

Uredheri i xhirimit i pergetitur ne nje formular te miratuar nga shoqeria nenschruhet nga dhenesi i aksionit ose perfeqesuesi i tij. Nese aksionet nuk jane shlyer teresisht urdherxhirimi nenschruhet edhe nga marresi. Nenschkrimet e paleve do te vertetohen nga noteri. Trasferimi i aksioneve falias si rrnjedhoje e trashgimise kryhet kalimi ne llogari ne base te nje dokumenti ligjor qe verteton trasferimin.

Shpenzimet per transferimin e aksioneve perballohen nga marresi per vec rastit te nje marreveshje midis paleve.

Aksionet e pashlyera per derdhjet e kerkuara nuk mund te pranohen per transferim.





SHLYERJA E AKSIONEVE

Neni 13

Aksionet e nenshkruesa ne pare lidhur me zmadhimin e kapitalit te shoqerise do te shqyrtohen sipas modaliteve te caktuara nga asambleja e pergjitheshme. Shlyerja e ketyre aksioneve nuk mund te jetë me e ulet se sa nje e katerta e vleres nominale. Shlyerja e vleres nominale te mbetur duhet te kryhet ne nje ose disa keste me kerkesa te drejtorit te shoqerise per nje afat pese vjecar nga data kur zmadhimi i kapitalit eshte bere perfundimtar.

Kerkesat e fondeve per shlyerjen e aksioneve u behen te njohura nenshkruesve te pakten 15 dite para dates se caktuar per cdo derdhje me later rekomande me kthim pergjigje per marrjen ne dorezim te adresuar tek cdo titullar i aksioneve.

Cdo vonese ne derdhjen e shumave te duhura nga shumat e pashlyera te aksioneve sjelle pagimin e interesave ne perqindjet ligjore dhe kjo pavarsisht nga veprimi personal qe shoqeria mund te ushtroje ndaj aksionerit qe nuk ka shlyer detyrimin dhe nje masat e zbatimit te detyruar te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

DREJTIMI I SHOQERISE

Neni 14

Organet drejtuese te shoqerise janë:


1. Asambleja e pergjithshme,
2. Keshilli mbikqyres,
3. Drejtoria.

ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME

Neni 15

Vetem asambleja e jashtezakonshme ka kompetencia te ndryshoje statutin me te gjitha dispozitat e tij.

Asambleja e jashtezakonshme mund te marri vendime te vlefshme vetem ne rast se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten 3/4 e aksioneve dhe ne te dyten 3/4 e aksioneve me te drejte vote. Ne te kundert mbledhja e dyte e asamblesa mund te shtyhet per nje date te me voneshme jo me larg se 2 muaj nga data e thirrjes se mbledhjes se pare. Asambleja e jashtezakonshme merr vendime me



nje shumice votash prej 3/4 qe u perkasin aksionerave te pranishem ose te perfaqesuar.

ASAMBLEJA E ZAKONSHME

Neni 16

Asambleja e zakonshme merr cdo vendim pervec atyre qe permenden ne nenin 16. Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem ne qofte se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten 3/4 e aksioneve. Ne rast se kjo mbledhje nuk realizohet ne te dyten nuk kerkohet asnjë tloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Te drejten per te marre pjese ne mbledhjen e asamblese e kane te gjithe aksioneret. Cdo aksion eshte i parabarte me nje vote.

Neni 17

Asambleja e zakonshme thirret ne mbledhje te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vtit financiar. Per thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjes zbatohen rregullat e percaktuara ne ligjin per shoqerite tregtare.

KESHILLI MBIKOYRES


Neni 18

KOMPETENCAT

Keshilli mbikqyres ushtron kontroll ndaj drejtorit per administrimin e shoqerise nga ana e tij. Perfundimi i operacioneve te parashikuara ne statut qe Jane kompetence e keshillit mbikqyres mund te behet vetem me autorizimin paraprak te keshillit mbikqyres.

Tejkalimi i kompetencave te ketij autorizimi duhet te respektohet nga te tretet qe nuk kane pasur dijeni per te.

Keshilli mbikayres ka te drejte te kryej ne cdo kohe verifikime dhe kontolle qe si i gjykon te nevojshme dhe te kerkoj te njihet me dokumentat qe si i gjykon te nevojshme per plotesimin e detyres se tij.



Drejtori i paraset raport keshillit mbikqyres te paktan nje here ne tre muaj. Brenda tre muajve nga abijija e vitit finanziar drejtori i paraset keshillit mbikqyres dokumentet e illogarisce vjetore dhe ne rest se eshte e nevojshme edo illoj dokumenti me qellim verifikimi dhe kontrolli.

Keshilli mbikqyres i paraset esamblese ne mbledhjen vjetore vrejtjet e tij mbi reportin e drejtorit si dhe ato mbi illogarite e vitit finanziar.

Mbledhjen e keshillit mbikqyres e therret kryetari i keshillit

- me inisiativen e vet,

- me propozim me shkrim te nje antari te keshillit mbikqyres,

Mbledhja duhet thirrur brenda 30 diteve nga momenti i paraqitjes se propozimit. Keshilli mbikqyres miraton rregulloren e tij e cila trajton me hollesi menyren e veprimit.

Keshilli mbikqyres delegon antaret e tij per kryerjen e Perkohshme te detyrave te drejtorise se shoqerise kur ajo per anesye te ndryshme nuk funksionon.

PERBERJA

Neni 19

Keshilli mbikqyres perbehet prej tre antares. Asnjeh antar i keshillit mbikqyres nuk mund te jetet antar i drejtorise.

Neni 20

Antaret e pare te Keshillit mbikqyres dhe eksperti i pare kontabel i autorizuat caktohen ne statut nga themeluesit e shoqerise.


Konkretnisht ato jene:

- | | |
|---------------------|---------|
| 1. Zyber Hasa | kryetar |
| 2. Koti Kocaj | antar |
| 3. Ramadan Bardholi | entar |

Antaret e pare te keshillit mbikqyres dhe eksperti i pare kontabel caktohen per nje afat 1 vjeclar.

Mbas perfundimit te afstit te antareve te pare te keshillit mbikqyres dhe ekspertit kontabel te autorizuar te caktuar ne statut emerimi dhe zgjedhja e radhes e tyre behet ne perputhje me nenet e meposhteme.

Cdo antar i keshilli mbikqyres pervec kompesisimit per shpenzimet e tij do te merre edhe nje pagese 150.000 leke ne vit.



Kjo pagese do te vendoset me mbledhjen e esamblese te shoqerise me 2/3 e votave. Kjo pagese do te jetë e përshtatshme për periudhen që çakton esambleja. Në qofte se antari i keshillit mbikqyres do te jetë entar i brendshem i shoqerise do te marri 25.000 leke ne vit.

Neni 21

Me mbarimin e afatit antaret mund te zgjidhen nga esambleja e aksionereve, po keshtu ata mund te shkarkohen ne odo moment nga esambleja e zakonshme e aksionereve per shkaqe te perligjura.

Ne rastin e vendeve bosh qe krijojen nga vdekja apo doreheqja e njerit ose disa antareve te keshillit mbikqyres, ky te beje emerime te perkohshme.

Kur numri i antareve te keshillit mbikqyres ka zbritur nen minimumi ligjor, drejtoria duhet te theras urgjentisht keshillit mbikqyres.

Neni 22

Per vlesherine e vendimeve te keshillit mbikqyres kerkohet qe te ftohen ne mbledhje gjithe antaret e tij dhe te jene te pranishem mbi 50 %.

Keshilli mbikqyres merr vendime me shumice te thjeshte votash te antareve te pranishem ose te perfajesuesve te tyre me perjashtim te cështjeve te me poshteme, per te cilat kerkohet jo me pak se tre te katertat e votave:

- Dhenia dhe marrja e kredive me leke dhe valute te huaj.
- Lidhja e kontratave me vlerë me te madhe se 30 % e kapitalit themeltar.
- Miratimi i autorizimit per formimin e degeve te reja te shoqerise

- Emerimin e drejtorit

Vota e kryetarit eshte percaktuese ne rast rezultati te barabarte.

Shperblimi i antareve te keshillit mbikqyres perballohet nga llogaria e shoqerise.

Neni 23

Antaret e drejtorise dhe te keshillit mbikqyres si dhe odo person qe thirret te marre pjese ne mbledhjet e ketyre organeve duhet te ruajne fshehtesine per te dhenat qe kene karakter te brendshem dhe qe cilesohen si te tilli nga kryetari.





DREJTORIA

Neni 24

Drejtoria e shoqerise behet nga drejtori i saj Petrit Xhunga. Ai i ushtron funksionet e tij nen kontrollin e keshillit mbikqyres.

Drejtori emerohet nga keshilli mbikqyres dhe eshte person fizik per nje periudhe tre vjeçare dhe mund te rimerohet. Si emerimi dhe shkarkimi i tij eshte kompetence e keshillit mbikqyres, por gjithemore shkarkimi behet per shkaqe te perligjura.

Kontraten e punes me drejtorin e shoqerise e lidh ne emer te saj kryetari i keshillit mbikqyres. Ne te fiksohet edhe menyrat e mase e shperblimit te tij.

KOMPETENCAT E DREJTORIT DHE MARRJA E VENDIMEVE PREJ TIJ

Neni 25

Drejtori ka kompetencia te plota per te vepruar ne cdo rrrethan ne emer te shoqerise. Ai i ushtron keto kompetencia brenda objektit te veprimtarise se shoqerise, por kufizohet ne ato kompetencia qe ligji per shoqerite trejtare ja jep shprehimisht keshillit mbikqyres dhe asamblese se aksioniereve.

Drejtori shqyrton dhe merr vendime sipas kushteve te caktuara ne kete statut.

Drejtori reporton per veprimtarine e tij dhe pengjigjet para keshillit mbikqyres per realizimin e qellimeve dhe angazhimeve qe Jane ne kompetence te tij.

Drejtori perfason shoqerine perpara te tretave, ne gjykata dhe arbitrazhe, administron pasurine dhe interesat e saj me perjashtim te kompetencave qe ju takojne organeve te tjere te shoqerise.

Klauzolat e statutit qe kufizojne kompetencat e drejtorit duhet te respektohen nga te tretet.


Drejtori mund te marri angazhime deri ne ate mase qe te mos kaloste vlera e 30% te kapitalit themeltar, ne te kundert duhet te marri autorizim nga kryetari i keshillit mbikqyres.

Eshe ne kompetencia te drejtorit te marri vendime per:

- nivelin e punesimit dhe pageve
- rregulloren e drejtorise dhe rregulloren organizative te shoqerise

- kushtet social jetesore te punonjesve.

Te gjitha vendimet e drejtorit protokollohen dhe nenshkrohen prej tij.



SIZA
SIZA

NDRYSHIME TE KAPITALIT THEMELOR

Neni 26

Ndryshimi i kapitalit themeltar behet sipas seksionit te gjashme kreu i 5 te ligjit "per shoqerite tregtare te R. Sh"

KONTROLLI I SHOQERISE

Neni 27

Ne shoqeri kontrolli ushtrohet nga eksperti kontabel i autorizuar. Eksperti kontabel i autorizuar emerohet nga asambleja e aksionereve e zakonshme. Shoqeria ka te drejte te emeroj nje ose disa prej tyre.

Ne cdo kohe te vitit ekspertet kontabel te autorizuar se bashku ose vec e vec bejne te gjitha vefifikimet e kontrollit qe i gjukojne te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne ne vend te gjithe dokumentacionin e vleresuar si te dobishem ne ushtrimin e funksionit te tyre dhe ne vecanti kontratat, librat e illogarise, dokumentat kontabel, regjistrat e proces verbalet.

Eksperti kontabel i bene te njojur drejtorise dhe feshillit mbikqyres :

- Kontrollet sotazhet dhe verifikimet qe kane kryer.
- Pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit ku ata kane verejtje.
- Parregullshmerite dhe pasaktesite qe kane zbuluar.

Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjen e drejtorise kur mbyllen illogarite e vitit financier si dhe ne mbledhjen e asamblese. Ata jene pengjegjes si ndaj shoqerise ashtu dhe ndaj te treteve per pasojet qe rrjedhin per faj dhe nivlleftesim te tyre ne ushtrimin e funksioneve qe kane.

Honoraret e eksperteve kontabel te autorizuar i ngarkohen shoqerise.


Paga e ekspertit kontabel eshte 50.000 leke.

RAPORTEL VJETORE

Neni 28

Ne fund te cdo viti finanziar drejtoria bene inventarin dhe illogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, si dhe harton nje raport me shkrim per admininstrimin te cilat ja paraqet se bashku me bilancin asamblese per shqyrtim.

Nga fitimi i realizuar gjate vitit finanziar pasi te jene zbritur po qe se ka hujjet e vitit te meparshem, heq menjane nje



shume te pakten 8 % te fitimit neto e cila destinohet per formimin e nje fendi rezerve te quajtur rezerve e domosdoshme. Cdo vendim i kundert eshte i pavleshem. Kjo tene menjane nuk eshte me e detyrueshme kur rezerva e domosdoshme arrin 1/3 e kapitalit themeltar.

Neni 29

Asambleja e zakonshme ne rast nevoje mund te formoje fonde te tjera pervec fondit te caktuar ne nenin 23 te ketij statuti. Pas plotesimit te shumes te fondevet te mesiperme pjesa e mbetur e fitimit caktohet per ndarje per aksioneret ne varesi me pjesa marrjen e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 30

Mardheniet e shoqerise me sindikatat rregullohen sipas legjislativit te Republikes se Shqiperise. Per te punesuarit do te zbatohen dispozitat ligjore qe normojne mardheniet e punes ne Republiken e Shqiperise.

Neni 31

Te gjitha ndryshimet ne aktin e themelimit, ne statut do te behen me vendim te asamblese se pergjithshme dhe do te depozitohen ne zyren e regjistrat tregtar te gjykates Tiranë.

SHKAQET E SHPERNDARJES SE SHOQERISE

Neni 32

Shoqeria shperndahet:


- kur imbaron afati i saj, pervec rastit kur asambleja e Jashtezakonshme ka vendosur zgjatjen e perifudhies se saj.
- me vendim te mbledhjes se Jashtezakonshme.
- kur shoqeria falimenton.

Grumbullimi i te gjitha aksioneve ne nje person nuk perbene shkak per shperndarjen e shoqerise.

LIKUJDIMI

Neni 33

Per likujdimin e shoqerise zbatohen rregullat e peraktuera ne ligjin "Per shoqerite tregtare". Asambleja e Jashtezakonshme cakton likujdatoret duke u peraktuar dhe fugite qe ata kane.




Neni 34

Odo mosmarreveshje qe mund te lindi midis paleve do te zgjidhet ne rruge mirekuptimi dhe ne rast se nje mosmarreveshje e tilli nuk zgjidhet me mirekuptim palet kane te drejte ti orejtohen gjykates kompetente.

Neni 35

Te gjitha ceshtjet qe nuk permenden ne kete statut dhe qe kane te bejne me shoqerine rregullohen sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare.
Statuti u hartua ne kater kopje me fuqi te barabarta, sot me daten 15.6.1996.

KRYETARI I KESHILLIT MBIKQYRES



REPUBLICA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE

Nr. 3.905 ep
Nr. 515 kol

V E R T E T I M

Sot me daten 1.08.1996 para meje noteres u paraqite Kujtim Hasa per identitetin e te cilil u sigurova me letter njoftim. Ai eshte madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar i cili deklaroj se statuti eshte shkruar sipas vullnetit te plete e te lire te aksionereve e nenshkroi para meje noteres dhe une e vertetoj sipas ligjit.

